



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 24 -2008  
Prishtinë, më 21 tetor 2008, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Kolë Berisha, Armend Zemaj,  
Ibrahim Makolli, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj dhe Džezair Murati.

**Munguan:** Branisllav Grbiq, Ramadan Gashi dhe Selvije Halimi.

**Të pranishëm:** Reshit Gashi – NDI.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 17 shtatorit 2008;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit;
4. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 17 shtatorit 2008**

**Kryetari** - I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë ndonjë vërejtje për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit**

**Kryetari** – Lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit e hapi diskutimin nen për nen. Po ashtu u morën parasysh edhe rekomandimet e OSBE-së nga anëtarët dhe nga kryetari i Komisionit.

Kryetari më pas fjalën ia dha përfaqësuesit të OSBE-së, që i arsyetoi rekomandimet e propozuara.

Komision vazhdoi me shqyrtimin e këtij projektligji deri te neni 30. Nenet e tjera do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme të Komisionit. Kryetari i falënderoi të gjithë anëtarët e Komisionit për kontributin që e dhanë.

## **4. Të ndryshme**

Në kuadër të kësaj pike u diskutua për vizitën e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në Gjykatën Komunale të Ferizajt me qëllim të njoftimit për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. U vendos që vizita të bëhet më 23. 10. 2008. Gjithashtu në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës u diskutua edhe për formimin e një grupi për hartimin e një rezolute sipas vendimit të Kuvendit.

Procesverbali u hartua nga stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni